ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Ministria e Puneve te Brendshme - MPB**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **214-22-8829-5-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Ndertimi SHFMU ne Pozhornan- Komuna e Vitise – vazhdimi i punimeve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

AAG PROJEKT" SH.P.K & AC ing shpk & Euro – Services shpk - Prishtinë

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Agim Ramadani Nr.82/7,
(Adresa)

Prishtine — ***10 000***
(Vendi) — *(Kodi postar)*

043 911119 —
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Agron Beqiraj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

aagprojekt@gmail.com
(Adresa elektronike)

10.02.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate.25.08.2022
Njoftimi mbi rezultatine AP-se 05.10.2022, ku grupi i OE AAG PROJEKT" SH.P.K &AC ing shpk& Euro – Services shpk – Prishtinë, eshte rekomanduar per dhenie te kontrates
Vendimi i OSHP-se 569-579/22, i nxjerr me daten19.01.2023
Njoftimi per anulim te procedurese. Me daten 23.01.2023.
Kerkesa per ri shqyrtim te vendimit .30.01.2023
Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per ri shqyrtim date.31.01.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [x]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Kerkesa per ri shqyrtim te vendimit 30.01.2023 Vendimi mbi refuzimin e kerkeses per ri shqyrtim date.31.01.2023

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qellimi Neni 7 - Barazia ne trajtim – jo diskriminimi Neni 52 – Njoftimi i kritereve per dhenien e kontrates Neni 59 - Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i ofertave Neni 69 - Aftesia teknike dhe Profesionale. **Ligji nr. 05/L-031, per proceduren e pergjitheshme administrative**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Kjo ankesë parashtrohët bazuar në dispozitat e nenit 108/A dhe 109, të LPP-së, ku grupi jonë i operatorëve ekonomik, si palë me interes juridiko – material, e perkufizuar edhe me nenin 4.1.26, të LPP-së fillimisht kërkon që:

- **Kerkesa 1** - OSHP, të autorizoj ekspert shqyrtues dhe deshmitar teknik sic parashifet me dispozita ligjore të LPP-së, (neni 107 dhe 113) dhe akte tjera nënligjore, me përgaditje përkatëse profesionale, përkatësisht ligjore në mënyrë që ankesa të trajtohet drejtë bazuar në prova dhe kërkesa të kualifikimit.
- **Kerkesa 2**, OSHP, të përjashtoj nga vendimmarrja anëtarin e bordit, z.Vedat Poteriqoi, meqë konsiderojmë se i njejti nuk është objektiv dhe gjykon njëanshëm ndaj njerit nga anetaret e grupit tonë, dhe si rrjedhojë bie ndesh me nenin 12, të Rregullorës së punës së OSHP-së, ku percaktohet: "*Shqyrtimi i ankesave dhe vendimarrja, ne OSHP, nuk do te behen ne ndonje menyre qe diskriminon ne favor apo kunder ndonje pjesemumarresi ne procedime apo ndonje personi tjeter*

jurdik apo fizik. Parimi u pavarsise dhe paansise ne vendimmarrje do te respektohet plotesisht".

Pretendimi ankimor 1.

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendëshme, bazuar në nenin 59, të LPP-së, ka themeluar komisionin e vleresimit të ofertave, ku paragrafi 1, i të njejtit nenë përcakton që: *"...Te gjithe anetaret e komisionit vleresues marrin pergjegjesi te plote individuale per vleresimin e kryer te ofertave..."* . Përderisa paragrafi 4, përcakton që: *"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.*

Pra grupi i OE-ve, "Aag Projekt, shpk & AC ing shpk& Euro – Services" shpk – Prishtinë, me datën 05.10.2022, është rekomanduar për dhënie të kontratës nga komisioni i vleresimit të ofertave, përkatesisht Autoriteit Kontraktues – Ministria e Puneve të Brendëshme.

Ndersa përmes vendimit të datës 19.01.2023, me nr. 569-579/22, i nxjerrë nga OSHP, kërkohët të anulohet ky aktivitet i prokurimit dhe atë në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, nenit 62 dhe nenit 117, te LPP-se, vendim ky i nxjerre ditën e 87, perkunder faktit se nuk eshte konsideruar si qeshtje e nderlikuar vendimmarrja.

Neni 117,paragrafi 1, i LPP-se "Afati i fundit për marrjen e vendimeve", percakton:

"OSHP do të nxjerrë vendimin e tij përfundimtar me shkrim, së bashku me një deklaratë me shkrim ***mbi arsyet faktike dhe ligjore mbi të cilat është marrë një vendim i tillë****, dhe ndonjë urdhër që nevojitet për zbatimin e vendimit të tillë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas skadimit të afatit kohor të specifikuar në paragrafin 7. të nenit 115 të këtij ligji, apo pas dorëzimit të informative shtesë dhe/apo shpjegimeve apo dëgjimeve sipas nenit paragrafin 3. apo 4. të nenit 116 të këtij ligji. Kur në çështje janë të përfshira fakte veçanërisht të ndërlikuara, OSHP mund të përcaktojë çështjen si çështje shumë të ndërlikuar dhe të shtyjë afatin për jo më shumë se njëzet (20) ditë për nxjerrjen vendimit të tij, deklaratës mbi arsyet dhe urdhrit të tij.*

Perveq shkeljes se afatit ligjore per vendimmarrje, konsiderojmë se vendimi ka te mera si ne aspekt formal ashtu edhe ne ate material, rrjedhimisht akti administrativ, si i tille nuk mund te prodhoje efekt juridik, pasi qe edhe me dispozitat e nenit 48, te ligjit nr. 05/L-031, te LPPA, arsyetimi i aktit administrativ, do te duhej te shpjegonte situaten faktike

mbi te cilin eshte nxjerr vendimi, shkaqet te cilat kane qene vendimtare gjate vleresimit te provave, bazen ligjore te vendimit dhe arsyen pse eshte e zbatueshme ne rastin konkret, shkaqet per te cilat nuk eshte pranuar ndonjeri nga pretendimet e pales dhe ne rastin e ushtrimit te diskrecionit, shpjegimin pse eshte ushtruar ne menyren e nxjerrjes se vendimit. Pra arsytetimi edhte i dukshem dhe i pa mjaftueshem, i paqarte, kunderthenes dhe si i tille eshte i barabarte me mungesen e tije apo edhe i pavlefshem juridikisht.

Per me teper vet dispozitivi dhe arsyetimi jane kunderthenes njeri me tjetrin , nuk dihet nese ankesat jane aporovuar ne teresi apo pjeserisht dhe apo janë refuzuar ne teresiësi, te pa bazuara.

Pretendimi ankimore 2.

Kundrejt ofertes se kompanis sone ne arsyetim, te te njejtit vendim nuk shpjegohet dhe arsyetohet anulimi i procesit te prokurimit. Ne fazen, pas vleresimit te ofertave, dhe pas publikimit te njoftimit per dhenie te kontrates vet OSHP, pikerisht perberja e njejte e ketije paneli, procedurat e prokurimit te anuluara ne kete faze te prokurimit i kane trajtuae si kunderligjore dhe ate duke u thirrut ne dispozitat e nenin 62- te LPP-se, ndersa anulimi i ketije aktivitetit te prokurimit nuk e konsumon asnjeren nga dispozitat e ketij neni.

- Shiqo vendimin nr. 362/22; vendimi nr. 346/22; vendimi nr. 342/22, e shum vendime tjera.

Kompania jone, se bashku me anetaret e grupit, ka prezantuar prova konkrete ne oferte, permes te cilave vertetohet se mbulohet cdo kerkese e kualifikimit perfshire edhe kriterin e dhenies si oferte me cmimin me te ulet.

Ne arsyetimin e te njejtit vendim, besojme pa dashje shtremberohet realiteti dhe nuk prezantohen provat shkresore ne menyre reale. Eshte potencuar se se nuk jane prezantuar deshmi - Certefika – kualifikimi me CCTV, ku i referohet vetem njeres nga certefikatat e z. Bujar Morina, e cila tani me ka skaduar validiteti i saje.
Instalimi i sistemeve apo edhe mirembajtja e sistemeve sowtuerike, BMS etj, ka te beje me teknologjin informative, teknologji e cila dit pas dite evulon dhe ndryshon. Pra kerkesa e kualifikimit eshte plotesuar, por quditerisht permes vendimit paneli shqyrtues i referohet vetem dates dhe validitetit te njejres nga shum certefikatat e prezantuara ne oferte. Grupi i OE-ve si teknik te certefikuar nga prodhuesi CCTV, ka prezantuar z. Morina, i cili ne oferte ka prezantuar CV, kontrate pune, Diplome Universitare, si dhe shume certefikata tjera permes te cilave vertetohet se i njejti eshte i certefikuar dhe tejkalon kualifikimin e kerkuar perfshire edhe eksperten per instalim te BMS, znj. Jansa Vasilevska. Pra ne si grup i OE-ve, kemi prezantuar prova permes te cilave mbulohet dhe tejkalohet kerkea e kualifikimit dhe si e tille do duhej te trajtohej ku OSHP, ka mundur te organizoj seance degjimore apo edhe te angazoi eksper te fushes.

Pretendimi ankimore 3.

Sa i perket paisjeve teknike, perkatesisht Grederin, paneli shqyrtues i Organit shqyrtues te

Prokurimit, permes shum vendimeve, kapacitetin me te madh te paisjeve teknike e ka trajtuar si avantazh per autoritetin kontraktues gje qe edhe ne kete rast do te duhejt se konsiderohej si i tille marre parasysh edhe natyren e aktivitetit te prokurimit. Madje paneli shqyrtues edhe pasjet me kapacitet me te vogel dhe te cilat nuk arrinin pragun – minimumin e kerkeses se kualifikimit te percaktuar nga AK, e konsideron si ekujvalente. Pra kompania jone konsideron se vet paneli shqyrtues nuk eshte konsistent ne vendimmarrje ne raport me kompani te caktuara.

- Shiqo vendimin e panelit shqyrtues te OSHP-se, me nr. 672/22.

Per me teper vet AK, pergjat procesit te vleresimit te ofertave dhe permes komisionit te vleresimit te ofertave, peshen e paisjes teknike Greder, e ka trajtuar si devijim te vogel dhe ate duke u argumentuar me dispozita ligjore, marre parasyshe cmimin e ofertes, qellimin e kontrates dhe natyren e saje.

Grupi i OE-ve ankes, "Aag Projekt"shpk & AC ing shpk& Euro – Services" shpk, mbetet me shpresen qe OSHP – Paneli Shqyrtues, me rastin e trajtimit te kesaj ankese dhe vendimmarrjes do te jete konstruktive dhe objektive ne raport me dispozitat ligjore parimet dhe rregullat ne fuqi, konsistencen lendore, dhe te nxjerr vendim te drejte, rrjedhimisht nese paneli shqyrtues e shef te arsyeshme, te organizoi seance degjimore ne menyre qe te sqarohen pretendimet tona ankimore bazuar ne dispozita ligjore.
Ne te kunderten kompania jone, detyrimisht do t'i realizoi te drejtat e saja permes organeve ligjzbatuese, perfshire edhe organet e ndjekjes per veprime te kunderligjeshme, pas marrjes se ekspertizave nga ekspert te fushave te certefikuar nga Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

<u>Prnadaj kompania jone, kerkon nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe:</u>

1. Te aprovohet ankesa jone ne teresi si e bazuar:
2. Te anuloi njoftimin per anulim te aktivitetit te prokurimit;
3. Te kthej lenden ne ri vleresim, perkatesisht
4. Te lejohet AK – MPB, qe te procedoj tutje sipas, njoftimit mbi rezultatine AP-se, te dates 05.10.2022, ku grupi i OE Aag Projekt"shpk & AC ing & Euro – Services shpk – Prishtinë, eshte rekomanduar per dhenie te kontrates.
   (konsistenca – shiqo vendimin PSH.nr.715–717/22)

<u>Si prove se bashku me ankese gjeni:</u>

- Vendimin e panelit shqyrtues te OSHP-se, me nr. 672/22 si dhe shkresat tjera lidhur me stafin dhe paisjen e kontestuar.
- Ndersa vendimet tjera te pershkruara lidhur konsistencen ne vendimmarrje jane te publikara ne ueb faqen e OSHP-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te konsiderueshme por tani per tani te pa kalkulura.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*